

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Menaxhmentit
Titulli i lëndës:	Praktika profesionale (Ditari i praktikës)
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II
Numri i orëve në javë:	4
Vlera në kredi - ECTS:	5
Mësimdhënësi i lëndës:	Mr.sc.Binaze Jashari
Detajet kontaktuese:	binaze.jashari@ushaf.net
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	
	Me qëllim që të njihen me problemet konkrete në thirrjen e ardhshme, studentët udhëzohen të kalojnë një numër të orëve të parashikuara të punës në kompani dhe institucione në mjedise më të ngushta dhe më të hapura. Studentët marrin detyra specifike në vendet e tyre të punës, kryerja e të cilave tregon nivelin e deri atëhershëm të përvetësimit të njohurive të parapara në programin e studimit. Detyrat që studentët marrin janë të lidhura drejtpërdrejt me detyrat që duhet të bëjnë pas diplomimit. Studentëve u caktohet një mentor nga një kompani - një institucion që monitoron dhe vlerëson kryerjen e detyrave. Gjatë praktikës profesionale mbahet Ditari <sup>1</sup> në të cilin futen të gjitha aktivitetet të cilat iu janë besuar studentit. Në fund të praktikës, lëshohet certifikata e praktikës së kryer, me nënshkrimin e dy personave: mësimdhënësit dhe mentorit të caktuar. Në certifikatë, përshkruhen me shkrim, rezultatet e vëzhguara, ose të arritura të studentit gjatë praktikës.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Qëllimi i lëndës është të takohen studentët në kushte praktike me probleme specifike në fushën e menaxhimit inxhinierik dhe të zotërojnë njohuritë praktike në lidhje me menaxhimin e inxhinierisë. Gjithashtu, qëllimi është që studentët të jenë në gjendje të aplikojnë njohuritë shkencore-profesionale dhe profesionale-aplikative në praktikë.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Pas përfundimit të këtij moduli, studenti do të jetë në gjendje: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Aftësimi i studentëve për aplikimin e njohurive teorike dhe profesionale të fituara më parë për të zgjidhur problemet konkrete praktike, inxhinierike-menaxheriale brenda një</li> </ul>

<sup>1</sup> Udhëzimi për praktikën profesionale ipet në vazhdim

	kompanie ose institucioni të zgjedhur. <ul style="list-style-type: none"> <li>• Njohja e studentëve me aktivitetet e kompanisë ose institucionit të përzgjedhur, mënyrën e bërjes së biznesit, menaxhimi.</li> <li>• Rolit të inxhinierëve të menaxhimit në strukturat e tyre organizative.</li> <li>• Te njihen me procesin e organizimit të punës.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	1	15	15
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	4	15	60
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	1	2
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	10	10
Përgaditja përfundimtare për provim	1	10	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			4
Projektet,prezentimet ,etj	3	2	6
<b>Totali</b>			<b>125</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Praktika profesionale , e cila zgjat 60 orë, kryhet nga studenti në semestrin IV nën drejtimin e një mësimdhënësi - praktikues të praktikës profesionale.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Studenti e kalon provimin nga praktika profesionale, bazuar në ditarin e shkruar të praktikës profesionale. Provimi ipet me gojë, dhe sukcesi i praktikës vlerësohet nga 6-10. Studenti, ditari i të cilit nuk pranohet, është i detyruar të përsërisë praktikën profesionale deri në regjistrimin në semestrin e V.		

<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	➤ <i>Të dhenat e fabrikes –organizimi i punes</i>
<b>Plani i dizajnuar i mësimi:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	Njohja me strukturat e organizimit te puneve menaxheriale dhe prodhuese në fabrikë.
<i>Java e dytë:</i>	Njohja me byronë konstruktive dhe pregaditjen e projekteve
<i>Java e tretë:</i>	Te dizajonohet dhe te programohet detali punues
<i>Java e katërt:</i>	Të njihet me programet prodhuese dhe asortimentin e prodhimit.
<i>Java e pestë:</i>	Njohje me përgatitje të dokumentacionit tekniko-teknologjik.
<i>Java e gjashtë:</i>	Te realizojn procesin prodhues te detalit te zgjedhur
<i>Java e shtatë:</i>	Kontorllimi dhe matja e detaleve te realizuara sipas standardeve
<i>Java e tetë:</i>	Të njihen me përgatitjen e punëve (planeve dhe programeve punuese).
<i>Java e nëntë:</i>	Analiza e te gjitha makinave ne repart ( Stabilimentet komplete të prodhimit, impiantet, veglat – mjete prodhuese dhe impiantet transportuese të transportit të brendshëm dhe të jashtëm).
<i>Java e dhjetë:</i>	Krijimi i raporteve per makinat perpunuese
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Furnizimi me materiale i resorëve të ndryshëm.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Njohja lidhur me mirëmbajtjen e stabilimenteve të makinave.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Njohja me njësinë e mbrojtjes higjieno – teknike.
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Njoja me proceset menaxheriale te udheheqjes reaprtit prodhues
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Prezantimi i Ditarit te praktikes
<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>	
<i>Mësimdhënësi cakton kriteret për vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime dhe rregullat e punes.</i>	

